

## MONETARY CONTROL

**Blerim Shehu**

VTC Prizren, Kosovo, bshehu76@hotmail.com

**Abstract:** This topic addresses the role of monetary control in terms of the means of payment and the means paid. The importance of monetary control is much more important because monetary assets are easier than transforming and transferring assets compared to other assets in enterprises or banking institutions. The audit reports provide accurate data on the activity carried out with the cash that enables the management to undertake concrete steps for management issues as well as possible. Control of money means control of money collection and payments, constituting one of the most important problems and moments of control-revision, because they provide the opportunity to acquire good credit, are easily transferred and are usually subject to abuses and other illegal actions more easily compared to all other property elements. Consequently, a very detailed and systematic scrutiny is required, by regularly and regularly counting cash at checkout and other bank accounts as well as a strict and detailed procedure.

The auditor should ensure that all monetary transactions are recorded until the closing of the books and that the balance sheet represents the real situation of the enterprise.

**Keywords:** Control of money, cash, reconciliations in cash and bank accounts

## KONTROLI I MJETEVE MONETARE

**Blerim Shehu**

VTC Prizren, Kosova, bshehu76@hotmail.com

**Abstrakt:** Kjo temë trajton rolin e kontrollit të mjeteve monetare përkatesisht mjeteve të arkëtuara dhe mjeteve të paguara. Rëndësia e kontrollit të mjeteve monetare është shumë më rëndësi për arsye se mjetet monetare janë mundësi me e lehte e transformimit dhe bartjeve të ndryshme në krahasim të asetëve të tjera në ndërmarrje apo në institucione bankar. Nga raportet e kontrollit sigurohen të dhëna të sakta për aktivitetin e bërë me mjetet monetare që i mundëson menaxhmentit të ndërmerr hapa konkret për qështje te menaxhimit sa më mirë. Kontrolli i mjeteve monetare do të thotë kontrolli i arkëtimit të parave si dhe pagesave, përbën një nga problemet dhe momentet më të rëndësishme të kontroll- revizionit, për arsye se japin mundësi për të përfituar të mira të çfarëdollojshme, transferohen lehtësisht dhe zakonisht i nënshtrohen shpërdorimeve dhe veprimeve të tjera të jashtëligjshme më lehtë në krahasim me të gjithë elementet e tjera pasurore. Për rrjedhim, kërkohet një kontroll shumë i hollësishëm dhe sistematik, duke numëruar shpesh dhe rregullisht paratë në arkë dhe në llogaritë e tjera bankare si dhe një regjim i rreptë dhe i hollësishëm i procedurave.

Revizori duhet të sigurojnë se janë regjistruar të gjitha veprimet monetare deri në mbylljen e librave dhe se bilanci kontabel paraqet gjendjen reale të ndërmarrjes.

**Fjalët kyçe:** Kontrolli i mjeteve monetare, arkës, rakordimet në mese të arkës dhe bankës

### 1. KONTROLI I MJETEVE MONETARE

K Kontrolli i mjeteve monetare, domethënë kontrolli i arkëtimit të parave si dhe i pagesave, paraqet një nga problemet dhe momentet më të rëndësishme të kontroll-revizionit sepse parat japin mundësi për të përfituar të mira të çfarëdollojshme, transferohen lehtë dhe zakonisht i nënshtrohen shpërdorimeve dhe veprimeve të tjera të jashtëligjshme më lehtë në krahasim me të gjithë elementet e tjera pasurore. Për rrjedhim kërkohet një kontroll shumë i hollësishëm dhe sistematik, duke numëruar shpesh dhe rregullisht paratë në arkë dhe në llogaritë e tjera bankare si dhe një regjim i rreptë dhe i hollësishëm i proceduarve, me qëllim që të argumentohen veprimet që kanë të bëjnë me mjete monetare. Mjetet monetare sigurohen nga shitjet me të holla në dorë, nga arkëtimit e klienteve, arkëtimi i letrave me vlerë, nga shitja e elemnteve të tjera pasurore, nga marrja e kredive, arkëtimi i interesve, nga rimbursimi i tatimeve.

Mjetet monetare – pagesat bëhen për të likuiduar furnitorët, për të likuiduar letrat me vlerë, blerjen e mallrave me para te gatshme, pagesat e shpenzimeve (qira, ineters).

## 2. QËLLIMI I KONTROLLIT TË ARKËS

Mjetet monetare sigurohen nga shitja me të holla të gatshme, nga arkëtimet e klienteve, arkëtimi i letrave me vlerë, nga shitja e elementeve të tjera pasurore, nga marrja e kredive, nga arketimi i interesave, nga rimbursimi i tatimeve. Pagesat bëhen për të likuiduar furnitorët, për të likuiduar letrat me vlerë, për blerjen e mallrave me të holla në dorë, pagesat për shpenzime, pagesën e taksave, shlyrjen e kredive.

Kontrolli i arkës ka si qëllim kryesor:

- a) Analizën dhe vlerësimin e procedurave të kontrollit të brendshëm, veprimet përkatëse me mjete monetare dhe
- b) Përcaktimi i shumës së mjeteve monetare në paraqitjen e rregullt të tyre në pasqyrat financiare të ndërrmarrjes.

Revizorët pas përshkrimit të procedurave të kontrollit të brendshëm që kanë të bëjnë me mjetet monetare, në fletët e kontrollit bëjnë kontroll të procedurave, me qëllim që të shikojnë nëse veprimet e ndryshme monetare dhe regjistrimet në librat e kontabilitetit janë bërë në përputhje me ato të parashikuara në procedurat e kontrollit. Në varësi me efektivitetin e kontrollit të brendshëm i cili aplikohet në faza të ndryshme të hyrjeve dhe daljeve të mjeteve monetare, do të përcaktohet madhësia e mostarve dhe kategoritë e mjeteve që do të zgjidhen për tu kontrolluar. Kontrolli i procedurës së veprimeve që kanë lidhje monetare do të tregojë në praktikë shkallën e efektivitetit dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në këtë mënyrë, revizorët vlerësojnë saktësinë dhe besueshmërinë e veprimeve të regjistruara në lidhje me mjetet monetare, drejtësinë e metodave të përdorura për përdorimin dhe regjistrimin e veprimeve ekonomike në lidhje me to dhe më gjërë. Përcaktimi i shumës dhe paraqitja e saj në bilancin kontabël, për përcaktimin e pasurisë neto të ndërrmarrjes, nuk paraqet problem të veçanta, sepse nuk ka problem të rivlerësimit të mjeteve monetare si disa elemente të tjera pasurore. Kështu do të bëhet rregullisht numërimi i parave dhe azhurimi i llogarive të tjera rrjedhëse pranë bankës. Azhurimi do të bëhet duke komunikuar drejtpërdrejtë revizorët me bankën dhe më pas do të vazhdohet me harmonizimin dhe rakordimin e tepricave të tyre me tepricat e librave përkatëse. Duhet të theksojmë se kontrolli i mjeteve monetare bëhet vetëm në ndërrmarrje që sipas kodit tatimor janë të detyruara të mbajnë librin e arkës. Madje nuk duhet bërë krahasim ndërmejt librit të arkës dhe librit të të ardhurave dhe shpenzimeve sepse nuk ka përputhje ndërmejt tyre. Në bizneset e vogla mund të llogaritim tepricën e arkës nga libri i të ardhurave dhe shpenzimeve duke shtuar dhe zbritur shpenzimet dhe të ardhurat, për të cilat nuk ka pasur hyrje-dalje mjeteve monetare.

### **Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm që u përket veprimeve ekonomike**

Objektivat e kontrollit të brendshëm analizohen dhe suksesi i tyre vlerësohet si më poshtë:

- a) Të gjitha veprimet ekonomike duhet të miratohen
  - Shitja me para në dorë bëhen vetëm nga persona të autorizuar dhe shuma e parave duhet të regjistrohet në kasat regjistruese
  - Arkëtimet nga klientët bëhen pasi të jetë plotësuar mandatarëtimimi përkatës.
  - Çeqet për tu paguar nënshkruhen vetëm nga arkëtari i pergjithëshëm ose nga persona të tjerë që janë të autorizuar për firmosje të çeqeve.
  - Plotësimi i çeqeve për të paguar kreditorët bëhet vetëm për veprime ekonomike të miratuara, të cilat vërtetohen me urdherpagesa, fatura dhe dëftesa të caktuara, në të cilat duhet të vihet shënim “u likuidua”
  - Pagesat për shuma të vogla nga arka e vogël bëhen vetëm kur ekzistojnë dëftesat përkatëse të pagesës dhe dokumente të tjera të shkruara.
  - Të gjithat çeqet që qarkullojnë më shumë se një vit duhet t’u shtohen mjeteve monetare dhe të çelet një llogari e detyrimeve afatshkurtra. Pagesat e çekut ose plotësimi i një çeku të ri duhet të shoqërohet nga një inspektim dhe kontroll i plotë.
- b) Kur të gjitha miratimet janë zbatuar, atëherë:
  - Duhet të kontrollohet totali i arkëtimeve dhe të bëhet krahasimi me tepricën e llogarisë arka në librin e madh dhe në librin analitik të klienteve.
  - Në përgjithësi nuk kërkohet të ushtrohet kontroll për të krahasuar nëse janë kryer pagesat e miratuara. Të inetersuarit për arkëtimin e parave ndjekin problemin e tyre
  - Çeqet të cilat rishitën për një vlerë më të madhe në krahasim me shumën e parashikuara dhe që qarkullojnë më shumë sesa koha e parashikuar duhet të kontrollohen sepse ende nuk kanë arritur në bankë.
- c) Ndërhyrje në elementet pasurore lejohet vetëm me autorizim të menaxherit
  - Të gjitha paratë duhet të depotizohen në llogari bankare dhe tërheqjet të bëhen vetëm në çeqe bankare që nënshtrihen nga persona kompetentë.

- Mjetet e pakta monetare që arkëtohen nga shitjet e ditës me para në dorë duhet të ruhen në kasafortë ose të mbyllën në arkat regjistruese me qëllim që të jenë të sigurara.
- Për një kontroll më të mirë, pagesat nuk duhet të bëhen menjëherë pas arkëtimit të mjeteve monetare. Të gjitha arkëtimet duhet automatikisht të depozitohen në bankë.
- d) Përgjegjesit e funksionit dhe përgjegjesit kontabël duhet të veçohen nga njëra-tjetra ose t'u nënshtrohen kontrolleve të përshtatshme kur ndarja nuk është e mundur.
  - Një person i llogarisë nuk duhet të ketë të drejtën dhe as përgjegjesin e ruajtjes së mjeteve monetare.
  - Personi që përdor mjetet monetare ose që kryen veprime monetare nuk duhet të ketë asnjë lidhje me llogarinë e ndërmarrjes dhe as më ndonjë përgjegjesi tjetër funksioni.
  - Kur ka shitje me të holla në dorë, atëherë në mënyrë të pashmangshme ekziston një lidhje e kompetencave ndërmejt magazinierit, arëktarit dhe llogaritarit, ndaj kërkohet një kontroll i kujdesshem i të gjithë regjistrimeve që kanë lidhje me të.
  - Ata persona hapin zarfat të cilat kanë brenda çeqe ose dëftesa arkëtimi ose depozitash, nuk duhet të kenë anjë kompetencë tjetër. Kontrolli duhet të bëhet duke përgatitur pasqyra për të gjitha arkëtimet e mjeteve monetare dhe transferimin e tyre në arkë dhe në vazhdimësi në bankë, duke dërguar një kopje në llogari, për regjistrime në librin e madh dhe në librat analitikë të debitorëve.
- e) Vetëm veprimet e porsakryera dhe të miratuara mund të regjistrohen në librin konabël
  - Ditari analitik i pagesave do të azhurohet nga punonjësit e zyrës së llogarisë nëpërmejt çeqeve. Regjistrimet monetare duhet të kontrollohen nëpërmejt pasqyrës së miratuar të pagesave të bëra furnitorëve dhe të tretëve të tjerë dhe në përputhje me buxhetin e daljes së parave.
  - Nuk është ndonjë problem shqetësues regjistrimi në ditarin analitik të arkëtimeve për arkëtimet monetare të pamiratuara.
- f) Të gjitha veprimet regjistrohen në librat kontabël.
  - Të gjitha arkëtimet regjistrohen në ditarin analitik të arkëtimeve. Kontrolli duhet t'i kushtojë vëmendje pasqyrës analitike të çeqeve që merren në rrugë postare si dhe filmave të arkave regjistruese
  - Duhet të kontrollohen të gjitha numrat serialë të çeqeve me qëllim që të sigurohemi se janë regjistruar të gjitha çeqet në librat përkatës. Çeqet e nxjerra jashtë përdorimit duhet të ruhen në arkivë, për të dëshmuar se nuk janë përdorur.
- g) Regjistrimet kontabile parqesin realisht shumat reale të veprimeve ekonomike  
Shumat e regjistrimeve duhet të kontrollohen dhe krahasohen me shumat e dokumenteve vërtetuese, me shumat e arkave regjistruese dhe me shumat e dëftese- pagesave.
- h) Veprimet ekonomike janë klasifikuar në rregull, për efekt të regjistrimeve kontabile.
  - Kur të gjitha çeqet për të likuiduar kreditorët janë paguar nga banka, duhet të kontrollohet nëse janë debituar llogaritë përkatëse të furnitorëve në librin analitik përkatës, duke rekorduar shumën e llogarisë “Furnitorët” në bilancin kontabël me shumën në librin analitik të furnitorëve
  - Kreditimet që rrjedhin nga shitjet me të holla në dorë duhet të klasifikohen sipas produkteve dhe kur kemi të ardhura të arkëtuara në avancë, pa u dorëzuar produkti i gatshëm ose pa u kryer shërbimi, duhet të çelet një llogari detyrimesh.
  - Arkëtimet nga klientët duhet të klasifikohen në përputhje me kategoritë e ndryshme të tyre dhe që lehtësojnë kontrollin.
  - Për një menaxhim efektivsi dhe një kontroll sa më rigoroz të regjistrimeve kontabile, informatat e mëposhtme duhet të përgatiten çdo ditë dhe pot ë jetë e mundur në mënyrë progresive nga fillimi i muajit deri ditën e përpilimit të pasqyrës.
  - Duhet të përgatiten bilance vërtetuese mujore provizore për librin e madh dhe për librat e mëdhenj ndihmës dhe të krahasohen shumat e tyre me shumat e librave dhe pasqyrave me qëllim që të sigurohemi se të gjitha veprimet ekonomike u regjistruan në rregull nëpër libra dhe u azhuruan në rregull librat e ndryshëm analitikë.

**Pesë menyra që organizata mund të forcojë kontrollet e saj të brendshme për trajtimin e parave të gatshme:**

Ruajtja e Aseteve: Mbroni paratë e organizatës në dorë duke i vendosur ato në një kabinet ose sirtar të mbyllur me qasje të kufizuar (ose më mirë akoma një pikë e sigurt). Kjo duhet të monitorohet për të siguruar që personeli i duhur të ketë qasje në trajtimin e parave të gatshme. Për shembull, çekët e imëta dhe / ose kontrollet bosh duhet të ruhen në një sirtar të mbyllur me qasje të kufizuar dhe vetëm personeli i autorizuar ka kombinimin ose çelësin.

Ndarja e detyrave: Autorizimi i një transaksioni, regjistrimi i një transaksioni dhe ruajtja e kujdestarisë së pasurive të lidhura duhet të trajtohen nga të gjithë personel të ndryshëm.

Nëse detyrat e trajtimit të parave të gatshme kryhen nga punonjës të ndryshëm, ndihmon për të siguruar që asnjë person të mos ketë kontroll të plotë mbi procesin e trajtimit të parave të gatshme.

Përgjegjësia: Sigurohuni që të gjitha transaksionet me para janë autorizuar, janë kontabilizuar siç duhet dhe janë dokumentuar siç duhet. Sigurimi i përgjegjshmërisë midis punonjësve gjithashtu ndihmon në zvogëlimin e rrezikut të faturave të humbura ose të vjedhura të parave dhe regjistrimin e gabuar të transaksioneve.

Pajtimet: importantshtë e rëndësishme të barazoni të gjitha llogaritë bankare në muaj për të siguruar që të gjitha transaksionet janë regjistruar me saktësi dhe plotësisht. Përveç pajtimeve bankare, organizata gjithashtu duhet të barazojë sistemet e tyre programore me sistemin e tyre të kontabilitetit, dhe të kryejë numërimin periodik të parave në dorë.

Monitorimi: Një proces rishikimi është thelbësor për të siguruar që kontrollet janë vendosur dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Menaxhmenti duhet të rishikojë dhe monitorojë rregullisht dhe të hetojë çdo veprimtari të pazakontë. Ky proces do të ndihmojë në përcaktimin nëse një kontroll nuk po funksionon siç duhet ose duhet të ndryshohet ose azhurnohet.

#### **Paraqitja e llogarisë “Arka” në bilancin kontabël dhe shënimet e nevojshme**

Zakonisht, të gjitha mjetet monetare paraqiten në bilancin kontabël me një shumë të vetme. Por, revizori duhet të dijë sa para gjenden në arkën e ndërmarrjes dhe sa nëpër banka. Gjithashtu keto para që paraqiten në bilancin kontabël, duhet të jenë “të lira” dhe në “dispozicion” për të kryer pagesa të menjëhershme, për t’u shërbyer veprimeve tregtare. Për këtë arsye kategoritë e mëposhtme të mjeteve monetare nuk duhet të paraqiten në arkë por në llogari të tjera të aktivit qarkullues ose të aktivit të qëndrueshëm, ose të shënohen në kllapa apo të specifikohen shënimet përkatese.

Këto raste janë si me poshtë:

- Paratë që janë ngrirë nëpër banka dhe që nuk janë drejtpërdrejt të përdorshme.
- Paratë e depozituara me afat ose në arkat e kursimit dhe që kërkohet t’u bëhet një njoftim paraprak bankës, për të qenë në dispozicion që kërkohen për tërheqje.
- Paratë që mbahen për qëllime të caktuara si për zgjerimin e fabrikës për likudim obligacionesh të cilët nuk mund të shërbejnë si kapital xhirues.
- Shuma e vogël të cilat duhet gjithëmonë të jenë gjendje në bankë sipas marrëveshjes mbi dhënien e kredive.
- Tepricat në banka të huaja jashtë shtetit të cilat nuk mund të përdoren si kapital xhirues nga degët jashtë shtetit dhe nuk mund të konvertohen drejtpërdrejt në monedhë vendase, për shkak të kufizimeve valutore
- Paratë që u jepen paradhënie nëpunësve për udhëtime. Keto paradhënie nuk janë në dispozicion për asnjë veprim monetar dhe në thelb përbejnë shpenzime të parapaguara
- Garancitë e ndryshme ose depozitat me kontratë, mesazhe garantuese.

Revizori duhet të jetë gjithashtu i sigurtë se janë regjistruar të gjitha veprimet monetare deri në mbylljen e librave dhe se bilanci kontabël paraqet gjendjen reale të ndërmarrjes.

#### **Rakordimi i tepricave të librave me tepricat e llogarive të bankave**

Rakordimi i tepricave të librave të mjeteve monetare të cilat mbahen nga ndërmarrja, me ato të llogarive të bankave, përbën një detyrë të rëndësishme për revizorët, të cilët kontrollojnë këtë rakordim, pavarësisht nga çdo rakordim që mund të ketë bërë zyra e llogarisë. Por, përse është e domosdoshëm ky rakordim dhe përse mund të mos rakordojnë tepricat e librave me tepricat e bankave

Shkaqet më të rëndësishme që vërehen në lidhje me keto diferenca janë:

- a) Çequet që qarkullojnë, të cilat janë të plotësuar dhe regjistruar nga ndërmarrja dhe që nuk kanë arritur akoma në bankë
- b) Depozitime postare, të cilat janë regjistruar në ndërmarrje, por jo akoma në bankë
- c) Shpenzime dhe furnitura nga banka, me anën e të cilave banka debiton llogarinë tonë, por ne nuk kemi bërë ende asnjë regjistrim në librat tona.
- d) Interesat bankare, qoft aktive apo pasive, ende të paregjistruara nga ana jonë.
- e) Çeqe të kthyera dhe shpenzime reklamimi. Çeqe të ndryshme të klientëve tanë që i nënshkruam dhe i depozituam në bankë, por që nuk u arkëtuan sepse klientët nuk kanë para në llogarin e tyre.

### **3. PËRMBLEDHJE**

Kontrolli i mjeteve monetare do të thotë kontrolli i arkëtimit të parave si dhe pagesave, përbën një nga problemet dhe momentet më të rëndësishme të kontroll- revizionit. Mjetet monetare japin mundësi për të përfutur të mira të çfarëdollojshme, transferohen lehtësisht dhe zakonisht i nënshtrohen shpërdorimeve dhe veprimeve të tjera të jashtëligjshme më lehtë në krahasim me të gjithë elementet e tjera pasurore. Për shkak të rëndësise së mjeteve monetare dhe transferit të lehtë të tyre kontrolli është shumë me rëndësi

Qëllimi i kontrollit të arkës – kontrollon mjetet monetare nga shitja me të holla të gatshme, nga arkëtimet e klienteve, arkëtimi i letrave me vlerë, nga shitja e elementeve të tjera pasurore, nga marrja e kredive, nga arkëtimi i interesave, nga rimbursimi i tatimeve. Gjithashtu kontrollohen pagesat që bëhen për të likuiduar furnitorët, për të likuiduar letrat me vlerë, për blerjen e mallrave me të holla në dorë, pagesat për shpenzime, pagesën e taksave, shlyrjen e kredive.

Llogaria arka në bilancin kontabël paraqitet një vlerë e vetme në zërin e bilancit, kjo vlerë është një tregues shumë i mirë i saktësisë së mjeteve monetare. Vlera e mjeteve monetare në bilanc është e nevojshme për revizorin, përmes të cilës analizon me gjendjen në librin e arkës dhe përshtatshmerin mes tyre.

#### LITERATURA

Karapici, V., (2011). Auditimi. Tiranë, Libraria Universitare UBT

Louwers, J., T., Ramsay, J., R., Sinason, H., D., Strawser, J., R., & Thibodeau, C., J., (2015). Auditing & Assurance Service. New York, McGraw-Hill Education

Maurano, A. (2018). Five Internal Controls for Handling Cash in Your Organization. website <https://kahnlitwin.com/insights/five-internal-controls-for-handling-cash-in-your-organization>

Messier Jr, F., W., (2007). Auditing. Zagreb, DBA, CPA McGRAW HILL, INC, (anglisht-kroatisht)

Messier, Jr., W., Glover, S., Prawitt, D., (2019). Auditing & Assurance Services: A Systematic Approach. New York, McGraw-Hill Education

Nikolla, Dh., Karapici, V., Peta, E., (2007). Aditmi. Tiranë, SH.B. Libri Universitar

Whittington, R., Pany, K., (2016). Principles of Auditing & Other Assurance Services, 20<sup>th</sup> Edition. New York, McGraw-Hill Education

Žager, L., Tusek, B., Barišić, I., (2014). Interna Revizija. Zagreb, Hrvatska zajednica računovođa i financijskih djelatnika

Accounts payable Chartered Institute of Internal Auditors, (2019) website <https://www.iaa.org.uk/resources/auditing-business-functions/finance/accounts-payable/>

<http://www.freebookcenter.net/Business/Accounting-Books.html>